VENDIM
Nr. 356, datë 1.12.2023

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 126, DATË 31.5.2022, "MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË 'ENERGY FINANCING TEAM TIRANA' SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"VENDIM

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2196/2 prot., datë 22.11.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 31.5.2022, "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë 'Energy Financing Team Tirana' sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, ndër të tjera, me vendimin nr. 126, datë 31.5.2022, ka vendosur që shoqëria "Energy Financing Team Tirana" sh.p.k. të përcjellë në ERE informacion çdo tre muaj, në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në dokumentimin e një vërtetimi të pastër tatimor.

Po ashtu, shoqëria "Energy Financing Team Tirana" sh.p.k., të përcjellë në ERE brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e vendimit, dokumente që vërtetojnë aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'u ofrohen klientëve.

- ERE, me shkresën nr. 2195/2 prot., e njoftoi shoqërinë për seancë dëgjimore në datën 6.11.2023, ora 11:00. Në seancën e zhvilluar me përfaqësuesit e shoqërisë "Energy Financing Team Tirana" sh.p.k., ndër të tjera, i kujtoi shoqërisë kushtet e lëna në vendimin nr. 126/2022.

- Shoqëria në seancën dëgjimore të datës 6.11.2023, të zhvilluar me përfaqësuesit e shoqërisë "Energy Financing Team Tirana" sh.p.k., informoi se në lidhje me kushtin e lënë në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s, procesi gjyqësor në shkallë të parë ka përfunduar dhe shoqëria e ka fituar atë, por Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve e ka apeluar dhe duke qenë se procedurat gjyqësore zgjasin, nuk kanë informuar, pasi nuk kanë një vendim të gjykatës të formës së prerë.

- Në vijim me shkresën e protokolluar në ERE nr. 2195/1 prot., datë 8.11.2023, shoqëria depozitoi dokumentacionin përkatës për sa informuar në seancën dëgjimore.

- Për sa sqarohet dhe depozitohet nga shoqëria në lidhje me plotësimin e kushtit të lënë në pikën 2, duke qenë se është ende në proces gjyqësore vlerësohet se shoqëria, të depozitojë në ERE menjëherë nga marrja dijeni e një vendimi të formës së prerë, vërtetimin e pastër tatimor ose vendimin e Gjykatës së Apelit.

- Në lidhje me kushtin e lënë në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s, ku shoqëria "Energy Financing Team Tirana" sh.p.k. duhet të përcjellë në ERE brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e vendimit, dokumente që vërtetojnë aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2195/1 prot., datë 8.11.2022, ka depozituar kontratat e qirasë me nr. 925 rep., nr. 691 kol., datë 27.10.2017 dhe nr. 961 rep., nr. 713 kol., datë 10.11.2017, ku në nenin 3 të këtyre kontratave është përcaktuar se: kontrata lidhet për një afat të papërcaktuar dhe ka hyrë në fuqi më datë 1 tetor 2017. Evidentohet se këto kontrata mbajnë datë të hershme, por rezulton se shoqëria nuk i ka depozituar përgjatë procedurës së rinovimit për sa kërkohet nga ERE, në kuadër të plotësimit të kushteve.

- Me depozitimin e këtij informacioni, rezulton se shoqëria aktualisht disponon kontratat e kërkuara në pikën 3, të vendimit të Bordit nr. 126/2022, ndaj vlerësohet që kjo pikë të shfuqizohet.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 126/2022 ndryshon dhe bëhet:

2. Shoqëria "Energy Financing Team Tirana" sh.p.k. të depozitojë në ERE, menjëherë nga marrja dijeni të një vendimi të formës së prerë, vërtetimin e pastër tatimor ose vendimin e Gjykatës së Apelit.

2. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 126/2022 shfuqizohet.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Energy Financing Team Tirana" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti